




Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec



PROCESVERBAL

KONSULTIM PUBLIK PËR PROJEKT
STRATEGJINË PËR MENAXHIMIN E UJËRAVE TË
ZEZA

Komuna e Rahovecit

Data: 10.04.2026

Ora: 14:00

Vendi: Salla e Kuvendit Komunal, Rahovec

Të pranishëm

- Anëtarët e grupit punues për hartimin e Projekt Strategjinë për Menaxhimin e ujërave të zeza Komuna e Rahovecit;
- Përfaqësues të institucioneve komunale;
- Përfaqësues të KFOR-it;
- Përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile;
- Qytetarë;
- Përfaqësues të mediave.

Rendi i ditës:

1. Hapja e konsultimit publik.
2. Prezantimi i Projekt-Strategjisë për Menaxhimin e Ujërave të Zeza në Komunën e Rahovecit.
3. Diskutimi mbi projekt-strategjinë dhe pranimi i komenteve e sugjerimeve.
4. Përmbyllja e konsultimit publik.

KONSULTIMI PUBLIK

Më datë **10 prill 2026**, në ora **14:00**, në **Sallën e Kuvendit Komunal në Rahovec**, u mbajt konsultimi publik për Projekt-Strategjinë për Menaxhimin e Ujërave të Zeza në Komunën e Rahovecit.

Takimin e hapi Perparim Krasniqi i cili i njoftoi të pranishmit me qëllimin e konsultimit publik dhe rëndësinë e strategjisë për përmirësimin e menaxhimit të ujërave të zeza, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të komunës.

Komuna e Rahovecit, me një popullsi prej rreth 41,799 banorësh dhe sipërfaqe prej 276 km², disponon një rrjet kanalizimi që mbulon 95.69% të popullsisë, por pothuajse të gjitha ujërat e zeza shkarkohen pa asnjë trajtim paraprak në Lumin Drini i Bardhë dhe degëzimet e tij. Aktualisht, i vetmi impiant funksional është sistemi lagun në fshatin Kramovik, i cili shërben vetëm për një vendbanim të vogël. Shkarkimi i vazhdueshëm i ujërave të patrajtuar përbën rrezik serioz për shëndetin publik, ndot burimet ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore, degradon ekosistemet ujore dhe pengon zhvillimin e qëndrueshëm socio-ekonomik të komunës. Sipas vlerësimeve, çdo vit shkarkohen në trupa ujorë mbi 925,000 m³ ujëra të zeza pa trajtim, duke krijuar një ngarkesë ndotëse që tejkalon kapacitetin vetëpastrues të lumenjve dhe rrezikon cilësinë e ujit edhe për komunat e poshtme të pellgut të Drinit.

Gjatë diskutimit:

- **Vehbi Duraku** vlerësoi rëndësinë e hartimit të strategjisë dhe theksoi nevojën që projektet prioritare të realizohen në përputhje me nevojat e qytetarëve. Poashtu ai pyeti për koston e implementimit të strategjisë.
- **Perparim Krasniqi:** Zbatimi i strategjisë është planifikuar në tre faza kryesore, me një kosto totale të parashikuar prej 17,500,000 €. Kostoja përfshin investimet kapitale për infrastrukturë, studimet teknike, mbikëqyrjen dhe një kontingjencë për rreziqe të papritura.
-
- **Rumir Zhuniqi**, arkitekt, pyeti për problematikat kryesore të identifikuara.

- **Perparim Krasniqi:** Mungesa e impianteve të trajtimit të ujërave të zeza Shkarkimi i ~925,000 m³/vit ujëra të patrajtuar në Drinin e Bardhë dhe degëzimet; rrezik serioz për shëndetin publik; ndotja e ujërave nëntokësore; degradimi i ekosistemeve ujore Infrastruktura e vjetëruar dhe e dëmtuar e kanalizimit Rrjedhje të mëdha nga gypa; bllokime të shpeshta; mungesa e dokumentacionit teknik; kosto e lartë mirëmbajtjeje Mungesa e ndarjes së sistemit fekal nga ai atmosferik Mbingarkesa e sistemit gjatë reshjeve intensive; vërshime urbane; ngarkesë e lartë hidraulike në impiantet e ardhshme Vërshimet e shpeshta dhe dëmet materiale Dëme materiale të konsiderueshme (>10 milion € në periudhën 2018–2021); rrezik për jetën e qytetarëve; dëmtimi i tokës bujqësore Ndotja industriale e pakontrolluar Shkarkime pa trajtim nga operatorët industrialë; ndotje e vazhdueshme e trupave ujorë; mungesa e monitorimit Mungesa e vetëdijes qytetare Hedhja e mbeturinave në lumenj; keqpërdorimi i sistemit të kanalizimit; mospagesë e tarifave; mungesa e raportimit të problemeve
-
- **Sylejman Daka,** inxhinier, rekomandoi që strategjia t'i kushtojë rëndësi të veçantë ndërtimit të sistemeve efikase për trajtimin e ujërave të zeza, monitorimit të vazhdueshëm të rrjetit dhe sigurimit të mirëmbajtjes së tij.
- **Perparim Krasniqi:** vlerësoj se jemi në përputhje me objektivat e Projekt-Strategjisë për Menaxhimin e Ujërave të Zeza. Strategjia parasheh zhvillimin gradual të infrastrukturës për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të zeza, si dhe përmirësimin e menaxhimit të rrjetit të kanalizimit.

Komentet dhe rekomandimet e pjesëmarrësve u evidentuan nga grupi punues dhe do të shqyrtohen gjatë finalizimit të dokumentit.

Përfundimet

Pjesëmarrësit e mbështetën Projekt-Strategjinë për Menaxhimin e Ujërave të Zeza në Komunën e Rahovecit dhe vlerësuan se dokumenti paraqet një bazë të mirë për përmirësimin e infrastrukturës së ujërave të zeza në komunë. U konstatua se komentet e paraqitura kanë karakter teknik dhe do të merren në konsideratë gjatë përgatitjes së versionit përfundimtar të strategjisë.

Takimi përfundoi në orën **15:00**.

Lajmi nga mbajtja e konsultimit: <https://rahovec.rks-gov.net/news/u-mbajt-konsultimi-publik-per-projekt-strategjine-per-menaxhimin-e-ujerave-te-zeza/>

